



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

## GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:008788  
Datë: 30.05.2024  
Numri i dokumentit: 05754602

**CAP.nr.1162/22**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, gjyqtari individual Arsim Hamzaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës- (KEK) - Prishtinë, kundër debitorit P.L nga fshati ,, , komuna e Gj,,,, në procedurën përmbarimore sipas dokumentit përmbarimor, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - departamenti i përgjithshëm, PPP.nr.34/19, të datës 04.04.2019, me datën **27.05.2024**, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**APROVOHET e themeltë** ankesa e debitorit së përmbarimit P.L nga fshati ,, , Komuna e Gj,,,, **PRISHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - PPP.nr.34/19, të datës 04.04.2019, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë – departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin e atakuar PPP.nr.34/19, të datës 04.04.2019, e ka refuzuar si të pabazuar, prapësimin e debitorit P.L nga fshati ,, , komuna e Gj,,,,, të parashtruar kundër urdhërit të Përmbaruesit Privat GJ.R në Gj,, P.nr.1404/18 të datës 20.12.2018

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori për shkak të *shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale*, duke propozuar që të aprovohet ankesa e parashtruar si e bazuar, ashtu që aktvendimin e shkallës së parë ta ndryshojë dhe të anulojë propozimin për përmbarim ose çështja t’ i kthehet gjykatës në shqyrtim dhe në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar kreditori.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- *Ankesa e debitorit është e themeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori i përmbartimit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a. - Prishtinë, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit së përmbartimit P.L nga fshati ,,,, Komuna e ,,,, ndërsa përmbartuesi privat me urdhërin P.nr.1404/18, të datës 20.12.2018, e ka lejuar ekzekutimin në bazë të dokumentit përmbartimor - ekstrakt nga librat afariste, për pagesën e borxhit në shumë prej 1,305.82€, të paraparë më gjerësisht si në dokumentin përmbartimor.

Kundër urdhërit për përmbartim P.nr.1404/18, të datës 20.12.2018, debitori ka ushtruar prapësim. Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.34/19, të datës 04.04.2019, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të parashtruar kundër urdhërit përmbartimor të lartcekur, dhe të njëjtin urdhër e ka lënë në fuqi.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata ka theksuar se nga provat e propozuara nga kreditori, e sidomos marrëveshja për pagesën e borxhit, e datës 27.08.2016 ka konstatuar se kreditori dhe debitori kanë lidhur kontratë për pagesën e borxhit me 18 këste, ndërsa nga ekstrakti i librave afariste i propozuar nga vet kreditori shihet se debitori ka paguar 14 kiste, dhe ka mbetur pa paguar edhe 4 këste. Sa i përket pretendimit për parashkrim ka theksuar se debitori me lidhjen e kontratës dhe pagesat gjegjëse e ka pranuar borxhin dhe nuk kemi të bëjmë me parashkrim, sepse me pagesat e bëra debitori e ka pranuar borxhin dhe në këtë mënyrë e ka ndërprerë afatin e parashkrimit, konform nenit 368 par.2 të LMD-së.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes sipas aktvendimit të ankimuar, tani për tani, nuk e përkrah Gjykata e Apelit e Kosovës, për shkakun se kjo gjykatë me vlerësimin dhe analizimin e tërësishëm të shkresave të lëndës, si dhe ankesës së debitorit, ka gjetur se aktvendimi i ankimuar është marrë me vërtetim jo të plotë dhe jo të drejtë të gjendjes faktike në këtë procedurë. Po ashtu kjo gjykatë ka gjetur se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 të LPK, lidhur me nenin 17 dhe 27 të LPP, si dhe aplikim të gabuar të dispozitave nga neni 360 par. 1 dhe 2 dhe neni 293 par.2 të LMD-së, për çka u deshtë që ky aktvendim të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Gjykata e Apelit vlerëson se në bazë të dispozitave të nenit 341 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Nr.04/L-077) parashihet se “*Me parashkrim pushon e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit*”, ndërsa në par.3 të këtij neni parashihet se “*Gjykata nuk mund ta merr parasysht parashkrimin në qoftë se debitori nuk thirret në të*”. Në nenin 342 par.1 të këtij ligji parashihet se “*Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të*

*ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”. Ndërsa me nenin 360 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve parashihet se “Parashkruhen për një vjet: ..... 1.3. kërkesat e postës dhe kompanive të telekomit për përdorimin e telefonit e të separateve postare, si dhe kërkesat e tjera të tyre që arkëtohen në afate tre (3) mujore apo më të shkurtra”. Në kuptim të këtyre dispozitave Gjykata e Apelit nuk mund ta pranoj këtë qëndrim të gjykatës së shkallës së parë, për faktin se nuk mund të kuptohet se si ka ardhur deri te një vendosje e tillë, lidhur me parashkrimin.*

Me dispozitat e nenit 345 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Nr.04/L-077) parashihet se **“Me punë juridike nuk mund të caktohet një kohë më e gjatë ose më e shkurtër e parashkrimit se sa koha e caktuar me ligj”**. Ndërsa në par.2 të këtij neni parashihet se **“Me punë juridike nuk mund të caktohet që parashkrimi të mos rrjedhë për një kohë”**. Andaj në këtë drejtim ekzistojnë pretendimet ankimore të debitorit se në rastin konkret borxhi kërkohet prej vitit 2002 deri më 2018, ndërsa lidhja e kontratës ka efekt vetëm në ndaljen e parashkrimit (pagesa e kësteve ndikon në ndaljen e parashkrimit të borxhit të paraparë me kontratë), ndërsa që e njëjta nuk mund ta zgjasë afatin e parashkrimit për borxhin e përgjithshëm.

Po ashtu, kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se në bazë të shkresave të lëndës, shihet se pagesat e bëra nga debitori janë bërë në mënyrë paushalle dhe nuk i përgjigjen pagesës së kësteve për konsumimin mujor, pasi që nuk është specifikuar se për cilat fatura janë kryer ato pagesa. Kjo bazuar në dispozitat e nenit 293 par.2 të LMD-së ku parashihet se **“Kur nuk ekziston deklarata e debitorit mbi llogaritjen, atëherë detyrimet përmbushen me radhë ashtu sikurse kanë arritur për përmbushje”**. Andaj pasi që nuk ka pasur specifikim se për cilën faturë është kryer pagesa, dhe shumat e paguara nuk kanë korresponduar me shumën e asnjërës prej faturave, konsiderohet se është paguar borxhi sipas faturave të para, andaj si të tilla nuk ndikojnë në ndërprerjen e parashkrimit.

Mbi bazën e shkeljeve të konstatuara si më lartë, kjo gjykatë gjeti se aktvendimi i ankimuar duhet prishur dhe çështja duhet kthyer në rivendosje tek gjykata e shkallës së parë, pasi që në rastin konkret nuk ka pasur kushte që i njëjti aktvendim të mund të ndryshohet nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që t'i ketë parasysh shkeljet e cekura si më lartë dhe që për evitimin e paqartësive në këtë lëndë përmbare, në kuptim te nenit 73 par.1 të LPP-së, gjykata e shkallës së parë eventualisht të caktoj seancë publike në të cilën do të ftoj palët në procedurë dhe pastaj përmes dëgjimit dhe deklarimit të tyre, ajo do të kishte mundësi objektive dhe reale që t'i eliminonte paqartësitë, duke mos përjashtuar edhe hetimin e ndonjë rrethane tjetër e cila do të ishte në interes të gjykatës për të vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë gjendjen faktike, të vlerësoj në mënyrë të drejtë nëse ka ndërprerje të parashkrimit apo parashkrim të pjesshëm të kërkesës, të përcaktojë në mënyrë të saktë periudhën kohore lidhur me parashkrimin, e pas kësaj gjykata duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të bie një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj. Në çdo rast veprimet dhe vendimet e gjykatës duhet të jenë në harmoni me dispozitat ligjore dhe standardet e gjykimit të drejtë.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”Në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77, të LPP-së.

**GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**CAP.nr.1162/22, datë 27.05.2024**

**Gjyqtari**  
**Arsim Hamzaj**